



Republika e Kosovës/  
Republika Kosova/Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -  
Statistical Agency of Kosovo*

**Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

## **Anketa e mbeturinave industriale 2010**



ENTITETI I STATISTIKËS SË KOSOVËS  
ZAVOD ZA STATISTIKU KOSOVA  
STATISTICAL OFFICE OF KOSOVA





Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova -*  
*Statistical Agency of Kosovo*

## **Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit**

# **Anketa e mbeturinave industriale**



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo

Publikuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)  
Data e publikimit: Dhjetor 2011  
© Agjencia e Statistikave të Kosovës  
Riprodhimi është i autorizuar me kusht që burimi të citohet  
Printuar nga: K.G.T. Prishtinë, Kosovë

Informata më të detajuara gjinden në internet ë ueb faqen:  
<http://esk.rks-gov.net/>

## **P a r a t h ë n i e**

Kjo është hera e parë që Agjencia e Statistikave të Kosovës ka organizuar dhe realizua anketën e statistikave të mbeturinave industriale.

Objektivi kryesor i këtij studimi është që të ofrojë të dhëna për mbeturinat nga sektori industrial në Kosovë. Rezultatet e paraqitura në këtë botim paraqesin një burim të parë të informacionit për mbeturinat nga sektori industrial në Kosovë.

Instrumentet statistikore të përdorura gjatë këtij hulumtimi janë në përputhje me Rregulloren (EC) Nr 2150/2002 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 25 Nëntorit 2002 mbi statistikave të mbeturinave, listës Evropiane të mbeturinave dhe Ligjit për Mbeturina në Kosovë, (Nr. 02 / L-30) të dizajnuara sipas rregulloreve të Bashkimit Evropian.

Mirënjohje e veçantë iu dedikohet Statistikave të Suedisë në ofrimin e ndihmës teknike, si dhe tek Sida për mbështetjen e ofruar.

Sidomos falenderojmë ekspertin nga Statistikat e Suedisë, zonja Klara Jakobsson dhe Louise Sörme që mundësuan këtë botim, si dhe ekspertin afatgjatë nga Statistikat e Suedisë dhënë Agjencisë së Statistikave të Kosovës, zonja Milva Ekonomi.

Ky publikim u përgatit nga:

Bajrush Qevani, Drejtor i DSBM  
Mr.sc.Haki Kurti, Shef i Divizionit DSBM  
Arta Salihu-Morina, Zyrtare DSBM  
Teuta Ademi, Zyrtare DSBM

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet për këtë publikim janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen me e-mail [agriculture@ks-gov.net](mailto:agriculture@ks-gov.net)

Dhjetor 2011

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së  
z. Isa Krasniqi

## Shkurtesat dhe Simbolet

BE	Bashkimi Evropian
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
AKMM	Agjencioni Kosovar i Mbrojtjes së Mjedisit
SIDA	Agjencioni Suedez për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar
NACE Rev.1.1	Klasifikimi i Aktiviteteve Ekonomike në Bashkimin Evropian
EWStat Classification	Katalogu Evropian i Statistikave të Mbeturinave
DSBA	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DPSIR	Gjendja, Indikatorët, Treguesit, Presioni dhe Përgjegjësit
OECD	Organizata Ekonomike për Kooperim dhe Zhvillim
EEA	Agjencioni Evropian për Mjedis

## Simbolet

t	Ton
%	Për qind

## Përmbajta

	Faqe
Informacione të përgjithshme .....	5
Objektivat dhe metodologjia e anketës .....	5
Metodologjia.....	6
Mbledhja e të dhënave.....	7
Definicionet.....	7
Rezultatet.....	8
Rezultatet mosta 1.....	10
Rezultatet mosta 2.....	13
Aneks 1.Pyetëtori.....	16





## **Informacione të përgjithshme**

Anketa e mbeturinave industriale në Kosovë u realizua sipas NACE Rev.1.1, i cili njëkohësisht është dhe klasifikim statistikor i aktiviteteve ekonomike. Mbeturinat janë klasifikuar si të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, sipas listës së mbeturinave.

Njësi raportuese janë të gjitha kompanitë me shtatë ose me më shumë punëtorë. Gjithashtu në mostrën e rastit janë përfshirë edhe popullsia e kompanive të vogla me më pak se shtatë punonjës si dhe kompanitë që nuk e kanë numrin e tyre të punësuarve në regjistrin e biznesit. Kompanitë e përfshira janë klasifikuar nga NACE Rev.1.1 në sektorët e aktiviteteve vijuese; të minierave dhe gurorë (C), industria e prodhimit (D) dhe energjia elektrike (E).

Ky është studimi i parë në shkallë të plotë për mbeturinat e prodhuara nga industria në Kosovë. Gjithashtu është viti i parë i publikimit të të dhënave nga prodhimi i mbeturinave nga aktivitete prodhuese i shprehur në ton, për vitin referues 2010, sipas kategorive; mbeturinave jo të rrezikshme dhe të mbeturina të rrezikshme.

### **1. Objektivat dhe metodologjia e anketës**

#### 1.1 Objektivi

Qëllimi i anketës së mbeturinave industriale 2010 ka qenë që të siguroj të dhënat për mbeturinat e gjeneruara nga industria. Të dhënat u mblodhën për dy kategori; mbeturina të prodhuara dhe mbeturina të përpunuara.

Objektivi i anketës 2010 ishte për të kryer anketim në shkallë të plotë për mbeturinat industriale, nga grupet NACE, C (miniera dhe gurorë), D (për Prodhim) dhe E (Energjisë).

Gjithashtu qëllim i anketës ka qenë të realizohet në përputhje me kërkesat ndërkombëtare dhe nevojat kombëtare të Kosovës.

## 1.2 Metodologjia

### 1.2.1 Korniza e anketës

Të gjitha procedurat e hulumtimit janë finalizuar gjatë muajit qershor 2011. Instrumentet statistikore për anketë janë përgatitur në maj 2011 në bashkëpunim me ekspertët Suedez.

Mbledhja e të dhënave është kryer në periudhën korrik-gusht 2011, e realizuar me intervistim sipas metodës ballë për ballë.

Plani i punës ka pasur këto faza; fazën përgatitore, të mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe faza e botimit-publikimit.

Gjatë fazës përgatitore janë kryer këto aktivitete : mostra e anketimit, pyetësi, variablat, plani kohor, manuali për intervistuesit, trajnimi i intervistuesve dhe ndërtimi i bazës së të dhënave. Mostra është përgatitur sipas regjistrit statistikor për biznes në dy nivele (mostër 1 dhe 2).

Trajnimi është mbajtur një ditë në ASK, për të gjithë stafin (shtatë zyra rajonale) i cili ka qenë i angazhuar në anketë.

Materiali i përgatitur është shpërndarë në të gjitha zyrat rajonale statistikore në Kosovë për të siguruar mbulim të plotë (sipas mostrës së anketës).

Korniza e mostrës sipas ASK-së dhe regjistrit të biznesit ka qenë 3635 kompani ne sektorët e mostruar . Ne kemi 311 kompani që i janë përgjigjur anketimit për mbeturinat industriale 2011, nga mostra gjithsej (mostra 1, 172 dhe mostra 2, 139).

Mostra një është përberë nga 432 kompani me shtatë ose më shumë punëtorë (anketa gjithsej).

Mostra dy është përberë 264 kompani me më pak se shtatë punonjës (mostra e anketës).

### 1.2.2 Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka përfunduar nëpërmjet intervistimi ballë për ballë nga ana e stafit të ASK-së në zyret rajonal me menaxherët e kompanive industriale që veprojnë në rajonin përkatës, bazuar në pyetësorë (Shtojca 1).

Të gjithë pyetësorët janë kontrolluar për kontrollin e cilësisë nga stafi i departamentit të statistikave të bujqësisë dhe mjedisit .

## 2. Definicionet

**Mbeturinat industriale:** mbeturinat e gjeneruara nga sektori i industrisë.

**Mbeturinat jo të rrezikshme,** mbetjet të cilat nuk paraqesin ndonjë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

**Mbeturinat e rrezikshme:** mbetje e cila sjell dëm dhe rrezik për shoqërinë, e cila tregon rrezik domethënës për shëndetin njerëzor apo mjedisin kur nuk menaxhohet në mënyrë adekuate. Mbeturinat e rrezikshme janë të ndezshme, gërryese, reaktive ose toksike. Mbeturinat e rrezikshme - janë mbeturinat të cilat kanë të paktën një nga karakteristikat e mëposhtme:

- shpërthyes, oksidante, djegëse, irrituese, e keqe, toksike, kancerogjene, gërryese, infektuese, teratogjerike, mutagjene, emetuese, gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin ose një acid, ka të ngjarë të prodhojë substanca tjera të rrezikshme, dhe eko toksike

- Sipas Ligjit për Mbeturinat në Kosovë, (Nr.02/L-30).


### 3. REZULTATET

Tabela 3.1: Gjithsej sasia e mbeturinave të gjeneruara nga sektori i industrisë (mostër 1 dhe 2)

Mostra	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rrezikshme, ton	Mbeturinat e rrezikshme, ton
1 and 2	C, D and E	580.154	36.241


Tabela 1: tregon shumën e vlerësuar të mbeturinave të krijuara nga sektori industrial në 2010. Gjithashtu sasia e përgjithshme e mbeturinave të rrezikshme vërehet ende me paqartësi për kompanitë industriale, se e mbeturinave jo të rrezikshme.

Grafiku 3.1: Mbeturinat e gjeneruara



Grafiku 3.2: Gjithsej mbeturina të gjeneruara nga industria, në për qindje (mostra 1 dhe 2)

Struktura e gjithsej mbeturinave të gjeneruara nga industria  
2010



#### 4. REZULTATET (mostra 1)

Tabela 4.1: tregon se sasia me e madhe e mbeturinave të gjeneruar është në sektorin e prodhimit (D) 393 625 ton ose 70% të shumës gjithsej të mbeturinave të gjeneruara (mbeturina nga mostra 1, 172 kompanitë që i janë përgjigjur anketës).

**Tabela 4.1: Sasitë e mbeturinave të gjeneruara dhe të mbeturinave të rrezikshme, nga kompanitë me shtatë ose më shumë punëtorë.**

Lloji i industrisë	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat e rrezikshme në ton
C- Miniera dhe gurore	172.686	35.500
D- Prodhimtari	393.625	699
E-Furnizimi me energji elektrike, gas, avull dhe ujë të nxehtë	255	-
Gjithsej	566.566	36.199

Grafiku 4.1: Struktura e mbeturinave nga industria, sipas kompanive me shtatë ose më shumë punëtorë

Struktura e mbeturinave të gjeneruara (mostra 1)





Tabela 4.2: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të trajtuara 2010, sipas kompanive me shtatë ose më shumë punëtorë (mostra 1)

Viti 2010	Mbeturinat jo të rrezikshme në ton	Mbeturinat e rrezikshme në ton	Të trajtuara <sup>1</sup> ose të dërguara për t'u trajtuar, në ton
Total	566.566	36.199	363.242

Tabela 4.2: tregon shumën e mbeturinave jo të rrezikshme, ose shprehur në përqindje 59% (grafiku 4.2)

Grafiku 4.2: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe të trajtuara nga industria 2010, në % (mostra 1)

Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe trajtuara (mostra 1)



<sup>1</sup> Trajtimi, përfshin proceset fizike dhe kimike, biologjike, termike, duke përfshirë qortimin/klasifikimin, që ndryshojnë karakteristikat e mbeturinave në mënyrë që të zvogëlohet vëllimi i saj i natyrës së dëmshme, lehtësimin për manipulim me mbeturina ose riciklim

Tabela 4.3: Mbeturinat e gjeneruara 2011 sipas tipit të industrisë në aktivitetin e prodhimit (mostra 1)

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat e gjeneruara, jo të rrezikshme, në ton	Mbeturinat e rrezikshme, ton
14	Miniera dhe gurore tjera	172.686	35.500
15-16	<sup>1</sup> Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve / Prodhimi i produkteve të duhantit	279.173	550
17-19	Tanimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	279	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	445	85
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	3.451	-
26	Prodhimi i produkteve të tjera jo-metalike minerale	94.490	34
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	415	-
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	-	-
36	Prodhimi i mobiljeve, prodhimi n.e.c	47	30
37	Reciklimi	15.326	-
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të nxehtë	11	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	244	-
Total		566.566	36.199

Tabela 4.3: tregon se sasia më e madhe mbeturinave të gjeneruar ka qenë në sektorin e prodhimit të prodhimeve të ushqimit dhe pijeve 279 173 tonë ose 49% (mbeturinat nga mostra 1, 172 kompanitë që i janë përgjigjur anketës).

<sup>1</sup> Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve; grupi NACE 15 përfshirë industrinë ushqimore dhe të pijeve në Kosovë



## 5 REZULTATET (mostra 2)

**Tabela 5.1: Mbeturinat e gjeneruara 2010 (mostra 2,139 ndërmarrjet që janë përgjigjur anketës)**

Lloji i industrisë	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat e rezikshme në ton
C- Miniera dhe gurore	2.654	1,0
D- Prodhimtari	10.934	40,5
E-Furnizimi me energji elektrike, gas, avull dhe ujë të nxehtë	-	-
Gjithsej	13.588	41,5

Tabela 5.1: tregon se sasia me madhe e mbeturinave është gjeneruar ne sektorin e prodhimit 10 934 tonë ose 80% të shumës totale të mbeturinave të gjeneruara (mbeturina nga mostra dy, 139 kompanitë që janë përgjigjur anketës), 20% është gjeneruar në sektorin e minierave dhe gurore.

Grafiku 5.1: Struktura e mbeturinave nga industria (mostra 2, 139 kompanitë që i janë përgjigjur anketës)

Struktura e mbeturinave nga industria 2010 (mostra 2)




Tabela 5.2: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe trajtuara (mostra 2)

Viti 2010	Mbeturinat e gjeneruara në ton	Mbeturinat e rrezikshme në ton	Mbeturinat e trajtuara në ton
Total	13.588	41,5	20.081

Grafiku 5.2: Sasia e mbeturinave të gjeneruara dhe trajtuara nga industria 2010, në % (mostër 2)

Sasia e mbeturinave te gjeneruara dhe trajtuara 2010 (moster 2)




Tabela 5.3: Mbeturinat e gjeneruara 2010 sipas tipit të industrisë në aktivitetin e prodhimit, (mostra 2, 139 ndërmarrjet që janë përgjigjur anketës)

Grupi	Lloji i industrisë	Mbeturinat jo të rezikshme në ton	Të rezikshme, në ton
14	Miniera dhe gurore tjera	2.654	1,0
15-16	<sup>2</sup> Prodhimi i produkteve ushqimore dhe pijeve / Prodhimi i produkteve të duhanit	9.440	-
17-19	Trainimi ose mbulesat nga lëkura; prodhimi valixhes, çanta dore, takëme, parzmore dhe këpucë	211	-
20-22	Botimi, shtypja dhe riprodhimi i mediave të regjistruara	37	-
23-25	Prodhimi i gomës dhe prodhimeve plastike	45	0,3
26	Prodhimi i produkteve të tjera jo-metalike minerale	344	-
27-29	Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve n.e.c	16	0,2
30-35	Prodhimi i pajisjeve të tjera të transportit	352	-
36	Prodhimi i mobiljeve, prodhimi n.e.c	265	-
37	Reciklimi	226	40,0
40	Furnizimin me energji elektrike, gaz, avull dhe ujë të	-	-
41	Mbledhja, pastrimi dhe shpërndarja e ujit	-	-
<b>Gjithsej</b>		13.588	41,5

Tabela 5.3: tregon shumën se sasia më e madhe e mbeturinave është gjeneruar në sektorin e prodhimit të prodhimeve të ushqimit dhe pijeve 9 440 tonë ose 69% (mbeturinat nga mostra dy, 139 kompanitë që janë përgjigjur anketës).

Shtojca 1. Pyetësi

# P Y E T Ë S O R

## Anketa e mbeturinave industriale 2010

### Identifikimi i biznesit

Numri i biznesit

Numri Fiskal

Emëtimi i biznesit \_\_\_\_\_

Shifra e veprimtarisë: Nace Rev.1:

Numri i të punësuarëve 2010 (100% me orar të plotë) \_\_\_\_\_

Numri i të punësuarëve 2010 (me kohë të pjesshme) \_\_\_\_\_

Pershkrimi i aktivitetit ekonomik: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Komuna \_\_\_\_\_

Vendi \_\_\_\_\_

Rruga: \_\_\_\_\_

Numri i ndërtesës \_\_\_\_\_

Te dhënat e pronarit: \_\_\_\_\_  
(Emri dhe Mbiemri) Tel

E-mail: \_\_\_\_\_

Personi kontaktues: \_\_\_\_\_  
(Emri dhe Mbiemri) Tel

Biznesi është anketuar Po/Jo \_\_\_\_\_

Nese jo, trego arsyen? \_\_\_\_\_

E-maili i personit kontaktues: \_\_\_\_\_

Dita dhe koha e anketimit:    \_\_\_\_\_  
Dita Muaji Viti Koha





## **Agjencija e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër**

**Agjencija e Statistikave të Kosovës**, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

**Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës**  
**Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**  
**Telefonat: +381 (0) 31 136**  
**Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 132**  
**Fax: +381 (0) 38 235 033**  
**E-mail: [agricultural@ks-gov.net](mailto:agricultural@ks-gov.net)**  
**Ueb-faqe: <http://esk.rks-gov.net/>**